

Lidhur me nenin 45 të ligjit mbi partitë politike (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë me numër 36/2009), Këshilli Qëndrorë i Partisë Demokratike Shqiptare në mledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 31.01.2010 vërtetoi :

**PROGRAMIN E  
PARTISË DEMOKRATIKE SHQIPTARE**

Veprimet e saja programore Partia Demokratike Shqiptare (më tutje: PDSH ) do ti orientojë dhe fokusojë në zhvillimin, përforcimin dhe realizimin e demokracisë, në planin politik, ekonomik, shoqëror, arsimor, edukativ dhe social etj.

I.

**Përbrenda planit politik**, PDSH si prioritet themelorë e vendosë: përfaqësimin dhe avokimin e interesave të shqiptarëve në teritorin e Republikës së Serbisë, para së gjithash Jugun e Serbisë, komunat Preshevë Bujanoc dhe Medvegjë (më tej: Lugina e Preshevës) mbrojtjen dhe përmirsimin e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, Ligj dhe standardeve ndërkombëtare.

PDSH, kërkon që aspiratat e shqiptarëve pakicë (më tej: shqiptarëve) ti realizojë përmes integrimit në familjen e madhe Evropiane, duke u angazhuar që Lugina e Preshevës të definohet si regjion i posatçëm në Republikën e Serbisë, në bazë të konceptit të regionalizimit dhe decentralizimit.

PDSH, do të angazhohet për garantimin dhe përforcimin e të drejtave dhe lirive, individuale dhe kolektive, të pakicës shqiptare, të proklamuara me konventa ndërkombëtare.

Parakusht i rëndësishëm për realizimin e të drejtave dhe lirive njerzore e qytetare për barazi të plotë nationale, do të insistojmë që këto vlera demokratike të larta ti proklamojmë dhe afirmojmë në shkallën më të lartë të demokracisë së vërtetë.

PDSH, do ti kundërshtojë të gjitha tendencat të cilat sjellin aspirate shoviniste dhe hegemoniste.

PDSH, do të angazhohet për parlamentarizem, tolerancë, dialog konstruktiv, barazi, ajo do t'i respektojë forumet dhe marrëveshjet e aprovuara, organet dhe institucionet legale, do të përpinqet të ketë politikën e sajë specifike luftën e planit politik.

Në suazat e Pushtetit Lokal, PDSH do të angazhohet që të krijoj dhe sigurojë kushte të domosdoshme për zgjedhje të lira në frymen e arritjeve të demokracisë moderne.

PDSH, do të angazhohet për veprim të përbashkët politik, bazuar në principet e vlerësimit dhe kyçjen e të gjitha subjektve politike, në rrugën e marrveshjeve demokratike, duke rrespektuar marrveshjet e arritura ndërpartiake, marrveshjet dhe konsenzuset.

PDSH, do të angazhohet në ruajtjen, kultivimin e cilësive dhe pasurive kombëtare, për zhllimin e shëndosh të mardhënieve ndërnjerzore, duke aplikuar principet e afirmimit të drejtës së barazisë, pandërprerë do të angazhohet për dinjitetin njerzorë, në përmirësimin dhe afirmimin e vlerave njerzore, trashëgimin kulturore, siç është ( BESA ) shqiptare, bujaria, dashuria ndaj fëmijëve dhe roli primar ndaj gruas shqiptare, kultivimi i pastërtisë dhe krenarisë familjare.

Për shprehjen e lirë të besimit fetarë individual dhe lirimt nga çdo ndikim (neveri), e cila mund të bëhet ndaj fesë, dhe për vlerësimin burimorë për fisnikëri dhe qëllime njerzore.

Kthimin e të zhvendosurve të cilët i kan lënë shtëpit e tyre dhe hapsirat ku kanë jetuar.

Traditat kombëtare, kultivimin e tyre, përdorimin e lirë të simboleve kombëtare, flamurit, gjuhës dhe shkrimit si në jetën private ashtu edhe atë shoqërore e publike, në mjetet e informimit, administratë, gjyqësi dhe organe tjera shtetërore, të cilat janë të drejta të pamohueshme të qytetarit.

PDSH do të angazhohet për amnestim të plotë dhe lirim të të gjith të burgosurve politik.

Secila marrëveshje që do të lidhet pas shpine dhe e cila do të jet në dëm të Shqipëtarëve, dhe e cila nuk do të ket për bazë vullnetin e tyre politik, do të konsiderohet jolegititime, ndërsa PDSH nuk do ta pranoj sit ë tillë.

II.

**Në planin ekonomik dhe shoqëror, PDSH do të angazhohet:**

\*Për ristrukturimin dhe zhvillimin e ekonomisë së mesme dhe të vogël si dhe integrimin e sajë në rrjedhën e teknologjisë së Evropës së Bashkuar, e të cilat janë të avansuara.

- \* Bashkëpunimin ekonomik me tregjet evropiane.
- \* Lëvizjen e lire të kapitalit, të mirave materiale, njerëzve dhe ideve të tyre,
- \* Për llojulloshmërinë e pasurive,
- \* Investimeve të kapitalit të jashtëm, veçanarisht investimet e Shqiptarëve që punojnë në botën e jashtme, duke pasur parasysh interest kombëtare,
- \* Mbrojtjen, shfrytëzimin dhe afirmimin e rezervave natyrore,
- \* Shfrytëzimin me plan të pasurive kombëtare, me rregullat dhe standardet e parapara evropiane dhe botërore,
- \* Zhvillimin e bujqësisë në format bashkëkohore, metodat e punës dhe përdorimin e makinerisë bashkëkohore.
- \* Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësorë, me standardet dhe normat e Evropës së Bashkuar, në rastet e ngritjes së objekteve të reja, duke marr parasysh pasojat eventuale ekologjike, nëse është e nevojshme, do të bëjmë edhe mbylljen e atyre që ndotin mjedisin jetësor.
- \* Investime për një ambient të pastërt ekologjik, në harmoni me politikën aktuale urbane, për banim dhe objektet tjera përcjellëse, mbrojtjen dhe kultivimin e vlerave arhitektonike tradicionale, urbanizimin e qendrave rurale, si dhe të gjithë infrastrukturën e modernizuar.

### III.

#### Në planin e procesit arsimorë, PDSH do të angazhohet:

- \* Pë ngritjen e vetëdijes kombëtare, forcimin uitetit të shqipëtarëve Brenda dhe jasht vendit,
- \* Kultivimin e traditave kombëtare dhe veticë njerzore, si dhe informimin e tyre me hapsirat e ndryshme në vend dhe botë,
- \* Për zhdukjen e analfabetizmit,
- \* Për kyçjen në sistemet e reja bashkëkohore të shkollimit dhe arsimimit.
- \* Për afirmimin dhe popularizimin e shkencave dhe teknikave bashkëkohore të cilat çojnë në shkollimin dhe arsimimin kualitativ të të rinjëve.
- \* Bashkëpunimin e lirë dhe të hapur me institucionet arsimore në vend dhe botë,
- \* Shkollim pa pagesë dhe shkollim të detyrueshëm fillorë dhe të mesëm,
- \* Të drejtën e themelimit të shkollave në bazë të vullnetit dhe iniciativave në harmoni me ligjin.
- \* Shkollimin në gjuhë amtare në të gjitha nivelet,
- \* Të drejtën ebarabartë të shkollimit në të gjitha institucionet universitare në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe në Mal të Zi ,

### IV.

#### Në planin e shëndetësisë dhe politikës sociale PDSH do të angazhohet:

- \* Sigurim të barabart shëndetsor, invalidor dhe pensional,
- \* Sigurim shëndetësor të gjithë qytetarëve pavarësisht statusit të tyre shoqëror,
- \* Mbrojtja e nënave dhe fëmijëve,
- \* Për kushtet e shëndosha të banimit dhe ushqimit
- \* Masat preventive për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve,
- \* Lufta kundër devijimeve të caktuara në shoqëri, alkoolizmit, drogës, prostitucionit dhe shprehive tjera negative për shoqërinë.
- \* Mbrojtja e personave të moshuar, të cilët janë të vëmuar dhe ata me të meta psiko-fizike,
- \* Mbrojtja materiale e të gjithë personave të papunësuar dhe atyretë cilët janë pa kushte elementare për jetesë,
- \* Lufta kundër të gjitha veprimeve kriminale,
- \* Dhe solidaritetit ndërkombëtar.

Në Preshevë  
31.01.2010

Kryetari i PDSH-së  
Ragmi Mustafa

